

BULETIN INFORMATIV

MBI VEPRIMTARINË E KLINIKËS LIGJORE TË KSHH
PËRGJATË GJASHTËMUJORIT TË PARË TË 2025



Gjatë periudhës 1 Janar 2025 – 30 Qershor 2025, KShH përmes Klinikës Ligjore ka trajtuar rreth **208 ankesa** të adresuara nga shtetas në gjendje të lirë, si dhe persona të privuar nga liria. Objekti i ankesave dhe pretendimet kryesore lidhen me:

- SHKELJE TË NENIT 6 TË KONVENTËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT (KEDNJ) – E DREJTA PËR NJË PROCES TË RREGULLT LIGJOR;
- SHKELJE TË NENIT 13 TË KEDNJ-SË – E DREJTA PËR DHËNIEN E NJË ZGJIDHJEJE EFEKTIVE;
- SHKELJE TË NENIT 3 TË KEDNJ-SË – NDALIMI I TORTUTËS DHE TRAJTIMIT ÇNJERËZOR DHE DEGRADUES;
- SHKELJE TË SË DREJTËS PËR INFORMIM NGA INSTITUCIONET PUBLIKE.

STAFI LIGJOR I KSHH KA OFRUAR:
KËSHILLIM LIGJOR (NË 150 RASTE),

NDËRHYRJE INSTITUCIONALE PËRMES
PËRCJELLJES SË ANKESAVE DREJT
INSTITUCIONEVE KOMPETENTE DHE
KËRKIMIN E INFORMACIONIT PËR
TRAJTIMIN E TYRE (**39 RASTE**),

**MONITORIME TË SEANCave
GJYQËSORE APO INSTITUCIONEVE TË
MBYLLURA,**

**SI DHE ASISTENCË LIGJORE PËR
PLOTËSIMIN E DOKUMENTACIONIT.**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII, Pallati "Tekno Projekt" Shk 2
Ap 10, Tirana-Albania

PO BOX no.1752;

Tel: 04 2233671

Cel: 0694075732 - 068 20 236 99

E-mail: office@ahc.org.al;

Web site: www.ahc.org.al

SHTETASIT E PRIVUAR NGA
LIRIA (TË
PARABURGOSUR/TË
DËNUAR APO TË
ARRESTUAR DHE NDALUAR
NË AMBIENTET E
KOMISARIATEVE) KANË
REFERUAR KRYESISHT
ANKESA MBI:



- ofrimin e shërbimit shëndetësor në këto institucione (mungesë medikamentesh; mungesë vizitash të specializuara; mungesa në trajtimin e këtyre ankesave nga administrata e institucionit);

- ushtrimin e dhunës fizike apo psikologjike nga personeli;

- mos transferimin drejt një institucioni afër vendbanimit dhe familjes;


- tej zgjatjen e proceseve gjyqësore dhe vonesave në mbylljen e hetimeve, caktimin e datave të gjykit dhe zbardhjes së vendimeve;

- tejkalimin e afateve të paraburgimit apo qëndrim tej masës së dënimit.



Shtetasi A.Ç, i dënuar referonte se prej 4 muajsh nuk po i mundësohej marrja e shërbimit stomatologjik pranë një klinike të specializuar, për shkak të nevojës për të kryer një ndërhyrje kirurgjikale.

Pas referimit të ankesës së tij u mundësua shoqërimi i tij drejt qytetit të Tiranës për marrjen e shërbimit shëndetësor.




Shtetasi N.P, i paraburgosur prej 8 muajsh, nuk kishte mundur të takonte familjarët e tij që nga momenti që gjykata kishte caktuar masën e sigurisë “arrest në burg”. KShH asistoi shtetasin ligjërisht duke e përcjellë kërkesën tek Prokurori i çështjes, i cili menjëherë pasi u vendos në dijeni miratoi lejimin e takimit të N.P me familjarët.

A.K, shtetasi i dënuar ishte transferuar drejt një IEVP-je larg vendbanimit dhe prej me tepër se 1 muaji po qëndronte në dhomën e pranimit të kësaj IEVP-je, pa u akomoduar në një mjedis banimi në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Përmes stafit të Klinikës Ligjore, u referua problematika drejt IEVP-së dhe u mundësua transferimi i tij drejt një IEVP-je tjetër.

KShH zhvilloi një monitorim në IEVP Korçë me qëllim verifikimin e ankesës së përcjellë nga shtetasi A.B, i cili pretendonte se ishte dhunuar nga disa punonjës policie. KShH i **rekomandoi** Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve marrjen e masave për informimin e përshtatshëm të të gjithë personelit në sistemin e burgjeve mbi standardet dhe rekomandimet e adresuara nga Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) mbi menaxhimin e rasteve të pretendimeve për dhunë, me qëllim parandalimin dhe adresimin e tyre.

U rekomandua gjithashtu, rishikimi i praktikës së vendosjes së masave disiplinore për shtetasit e diagnostikuar me çrregullime të shëndetit mendor, me qëllim zbatimin e regjimit disiplinor lehtësues, ku masat merren për aq sa kuptohen dhe për aq sa i shërbejnë qëllimit rehabilitues të dënimit.



Janë monitoruar dy raste të humbjes së jetës së shtetasve në ambientet e **IEVP “Jordan Misja”** dhe **Bllokut të Sigurisë, Tiranë**. KShH përmes reagimeve publike ka vendosur theksin tek ofrimi i shërbimeve dhe ndihmës mjekësore në kohë dhe në përshtatje me nevojat që shtetasit e privuar nga liria paraqesin, me qëllim parandalimin e situatave të tilla.

Autoritetet duhet të sigurojnë që kur është e nevojshme nga natyra e një gjendjeje mjekësore, mbikëqyrja të jetë e rregullt dhe sistematike dhe të përfshijë një strategji gjithëpërfshirëse terapeutike që synon trajtimin adekuat të problemeve shëndetësore të të paraburgosurit ose parandalimin e përkeqësimit të tyre, në vend që t'i adresojë ato në bazë simptomatike.



KSHH NË ROLIN E “AMICUS CURIAE”




SHTETASI RUS I.K, U EKSTRADUA NGA TERRITORI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DREJT FEDERATËS RUSE BAZUAR NË URDHËRIN E MINISTRIT TË DREJTËSISË, I CILI KISHTE VENDOSUR SI AFAT EKSTRADIMIN MË DATË 30.11.2024.

NË PO TË NJËJTËN DATË MBLEDHJA E GJYQTARËVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE, VENDOSI PEZULLIMIN E TË GJITHA PROCEDURAVE TË EKSTRADIMIT TË KËTIJ SHTETASI DERI NË NJË VENDIMMARRJE TË DYTË. NDËRSA PROCEDURAT PËR EKSTRADIM JANË PEZULLUAR ME NJË VENDIM TË DETYRUESHËM TË GJYKATËS KUSHTETUESE, I.K DE FACTO ËSHTË EKSTRADUAR.

KSHH I PËRCOLLI GJYKATËS KUSHTETUESE NJË **OPINION MIQËSOR (AMICUS CURIAE)** NË INTERES TË GJYKIMIT ME OBJEKT “KONSTATIMI SI ANTIKUSHTETUES I EKSTRADIMIT TË I.K NË FEDERATËN RUSE”, E CILA U PRANUA TË ADMINISTROHEJ NË GJYKIM NGA MBLEDHJA E GJYQTARËVE TË KËSAJ GJYKATE.

SHTETASI L.B, I DËNUAR ME BURGIM TË PËRJETSHËM KA KËRKUAR RISHIKIMIN E VENDIMIT PENAL TË DHËNË NDAJ TIJ, NË BAZË TË PARASHIKIMEVE TË KODIT TË PROCEDURËS PENALE.

PASI KJO KËRKESE U RRËZUA NGA GJYKATA E SHKALLËS SË PARË DHE AJO E APELIT, GJYKATA E LARTË VENDOSI PRISHJEN E VENDIMIT TË GJYKATËS SË APELIT DHE DËRGIMIN E ÇËSHTJES PËR RISHQYRTIM ME NJË TJETËR TRUP GJYKUES.



KSHH PËRMES NJË AMICUS CURIAE I SUGJEROI GJYKATËS SË APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, TIRANË CAKTIMIN E NJË DATË TË AFËRT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES, DUKE MARRË NË KONSIDERATË RRETHANAT KONKRETE TË RASTIT. GJYKATA CAKTOI MENJËHERË DATËN E GJYKIMIT DHE TASHMË PËR RASTIN KA NJË VENDIMMARRJE.

